



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 142/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, në seancën e panelit të mbajtur me 07.10.2013, mori këtë:

V E N D I M

Konstatohet e tërhequr ankesa Anr. 142/2013 e datës 03.10.2013, nga Lëvizja Vetëvendosja (LVV), dega në Ferizaj

Arsyetim

PZAP, ka pranuar një kërkesë për tërheqje të ankesës Anr. 142, datë 06.10.2013, nga LVV me të cilën pala ankuese kërkon që mos të shqyrtohet ankesa e lartcekur, me arsyetimin se subjekti politik në fjalë ka kërkuar ndjesë për një akt të tillë nëse kjo vepër është kryer nga anëtarët e tyre.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës Anr. 142/2013, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos ta shqyrtoj ankesën në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 142/2013 më datën 07.10.2013

